

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-210/15

Prishtinë,

28 Mars 2018

Në çështjen juridike të:

F. I.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KKPK), KPCC/D/R/264/2014, (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA01086), të datës 21 Tetor 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 28 Mars 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e F. I., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/264/2014, të datës 21 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP me numrin KPA01086.
2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/264/2014, i datës 21 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP me numrin KPA01086.

Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale

1. Më 17 Gusht 2007, F. I. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), me të cilën kërkon kompensimin për ngastrën kadastrale me nr. 2976, në sipërfaqe prej 0.03.73 ha e cila gjendet në ish rruga “JNA”, Komuna Kadastrale Pejë, pa e specifikuar datën e humbjes së pronës. Sipas pretendimeve të palës ankuese prona ishte bartur në emër të K.Pejë, pa një akt ligjor të vlefshëm.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij pala ankuese ka dorëzuar në AKP:
 - Certifikatë Nr.01-464/2026/97 e datës 13 Maj 1997 e lëshuar nga Komuna e Pejës-Dega për urbanizëm , çështje komunale banesore dhe pronësore juridike që dëshmon se sipas evidencës kadastrale dhe të administratës komunale nuk është gjetur se ngastrat e përmendura në certifikatë janë eksproprijuar;
 - Aktvendim i Komisionit të Eksproprijimit të Pejës me numër EKC. Br. 5/19 i datës 30 Shtator 1953 me të cilin familja I. eksproprijoheshin për nevoja publike 303 metra katror tokë;
 - Aktvendim i Komisionit të Eksproprijimit të Pejës me numër EKC. Br. 5/30 i datës 30 Shtator 1953 me të cilin familja I. eksproprijoheshin për nevoja publike 21 metra katror tokë;
 - Parashtresë e palës ankuese drejtuar Gjykatës Komunale në Pejë lidhur me padinë civile C.Nr.54/01, me të cilin pala ankuese i drejtohet gjykatës me një ekspertizë gjyqësore që përfshinë historikun e zhvillimit kadastral të pronës së kërkuar prej vitit 1932 deri me ditët e sotme
 - Kopje e planit kadastral sipas lëndës civile Nr. 195/05 dhe ekspertizë e ekspertit gjeodet M. M. e datës 28 Janar 1997 për lëndën civilC.Nr. 65/95

- Aktgjykim i Gjykatës Komunale në Pejë, C.Nr.54/01 i datës 30 Mars 2001 me të cilin i njihet e drejta e shfrytëzimit palës ankuese dhe të tjerëve midis tjerash edhe në pronën e kërkuar “ nastra kadastrale nr 3021 me kulturë rrugë me sipërfaqe prej 0.00.33 h”(i formës së prerë me 28 Qershor 2001)
 - Njoftim nga Komuna e Pejës, Zyra e Kryeshefit ekzekutiv lidhur me kërkesën për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë C.Nr 54/2001 me të cilin Komuna e njofton palën ankuese se Avokati Publik i Komunës ka ushtrur kërkesë për përsëritjen e procedurës.
 - Aktvendim i Gjykatës së Qarkut në Pejë AC.Nr.262/03 i datës 25 Maj 2004 me të cilin prishej aktvendimi i Gjykatës Komunale në Pejë për lejimin e përsëritjes së procedurës.
 - Kërkesë e datës 8 Qershor 2010 drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës për rishqyrtim-përsëritje të procedurës;
 - Përgjigje e Gjykatës Supreme të Kosovës KCRJ.Nr.1/2010 me të cilën dergohej lënda në kompetencë të Gjykatës së Qarkut në Pejë për kërkesën për Përsëritje të procedurës.
 - Përgjigje e Komunës së Pejës reference I-463/010 lidhur me kërkesë e palës ankuese drejtuar komunes.
 - Përgjigje e Komunës së Pejës reference LP 2008/11 lidhur me kërkesë e palës ankuese drejtuar komunes.
 - Përgjigje e Komunës së Pejës reference LP 2009/11 lidhur me kërkesë e palës ankuese drejtuar komunes.
3. Identifikimi i kërkesës ishte bërë me 28 Maj 2010 përmes publikimit të kërkesës në Gazetën e KPA-së nr. 1 dhe ishte shpërndarë në të gjitha zyrat dhe institucionet relevante të Regjionit të Pejës dhe ishte publikuar në byltenin e UNHCR-së. Prona ishte gjetur ndërtesë dy katëshe,(kati parë lokal afarist), dhe askush nuk ishte përgjegjor në kërkesë. Me datën 25 Janar 2011 prona e kërkuar ishte ri identifikuar duke u konstatuar se identifikimi i bërë herën e parë ishte i saktë.
 4. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, kishte verifikuar pozitivisht dokumentat kadastrale përveç fletës poseduese nr.313, nga ishte konfirmuar se ngastra kadastrale 2976, është e evidentuar në emër të H. B. I., (azhuruar në bazë të kontratës së shitblerjes Vr.nr.7242/02, të dt. 02.09.2002, po ashtu ishin konfirmuar edhe Aktgjykimet e gjykatave kompetente.
 5. Më 21 Tetor 2014, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/R/264/2014, vendosi që të hedhë kërkesën, për shkak se humbja e posedimit dhe pamundësia e shfrytëzimit nuk lidhej drejtpërdrejt me konfliktin e armatosur që kishte ndodhur në vitet 1998-99. Në paragrafin 53 arsyetohet hedhja e kërkesës për kompensim të dëmit fizik ose për humbjen e shfrytëzimit për pronën e kërkuar, për shkak të mungesës së Juridiksionit të KKPK-së, sipas Rregullores 2006/50, e miratuar me Ligjin nr.03/L-079.

6. Me datë 19 Janar 2015, Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese. Ankesa ishte paraqitur më 16 Shkurt 2015.

Pretendimet e palës ankuese

7. Pala Ankuese thekson se vendimi i KKPK-së përmban shkelje thelbësore të së drejtës materiale dhe procedurale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
8. Pala Ankuese pretendon se nuk qëndron konstatimi i KKPK-së se humbja e posedimit nuk lidhet me konfliktin apo rrethanat që lidhen me të sepse deklaroi se ka pas afër konfirmimin të të drejtës pronësore në Gjykatën e Pejës në vitin 1997 por edhe pse është përfunduar procedura e të provuarit nuk është nxjerrë aktgjykimi. Në vitin 2001 Gjykata Komunale me aktgjykim të formës së prerë i ka njohur të drejtën e shfrytëzimit dhe zyra kadastrale me keqpërdorim të detyrës zyrtare i ka bërë ndryshimet kadastrale.
9. Sipas palës ankuese, vendimi nuk e konsideron se ndryshimi i pronësisë është bërë pa bazë ligjore dhe edhe pse toka është kompensuar kur është bërë eksproprijimi shtëpia nuk është kompensuar e edhe prishja është bërë pa pëlqimin e tij dhe pa kompensim.
10. Pala ankuese me ankesë kishte bashkangjitur provat e njëjta të cilat ishin prezantuar në shkallë të parë si dhe dokumente që dëshmojnë se pala ankuese ka shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në disponim tek gjykatat e rregullta të cilat nuk janë objekt shqyrtimi i këtij Aktgjykimi

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

11. Gjykata Supreme shqyrtoi vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (në tekstin e mëtejme: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese gjeti se: *Ankesa është e pranueshme sepse ajo është paraqitur brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 i cili parasheh që pala mund të paraqes ankesë kundër Vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin.*

Meritat e ankesës

12. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave në dosje të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
13. Vendimi i KKPK-së është i drejtë. Gjykata nuk ka mundur të gjejë vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.

14. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të KKPK-së për ri-posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e vërteton të drejtën e tij/saj pronësore mbi pronën private por edhe që ai/a jo aktualisht nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat e tilla pronësore mbi pronën përkatëse për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 apo rrethanave që rezultojnë nga ky konflikt.
15. Gjykata Supreme vëren se pala ankuese, edhe pse ka pretenduar të drejtën ligjore mbi pronën, nuk ka prezantuar asnjë dokument për të mbështetur të drejtën e tij qe mund ta ketë pasur para ose gjatë konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 apo rrethanave që rezultojnë nga ky konflikt .
16. Dokumentet e paraqitura nga pala ankuese nuk dëshmojnë të drejtën pronësore të palës ankuese mbi pronën e kërkuar dhe fakti i eksproprijimi sipas pretendimeve të palës nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga KKPK-ja e as nga Gjykata Supreme për mungesë të legjislacionit dhe te juridiksionit lidhur me eksproprijimin e vitit 1953. Ligji Nr. 03/L-079 nuk ka mjete ligjore në disponim të palëve për këtë periudhë për shkak të përkufizimit kohor dhe përmbajtjesor të përshkruar në nenin 3.1.1 të Ligjit nr. 03/L-079 .
17. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka gjetur se është udhëhequr procedurë në gjykatën e rregullt që në vitin 1997 gjë që e pohon edhe pala ankuese. Ai pretendon se toka e eksproprijuar është kompensuar sipas ligjit të atëhershëm në fuqi kurse shtëpia e banimit nuk ishte kompensuar. Kërkesa fillestare e palës ishte që të kompensohej dëmi materialë dhe kompensimi i fitimit të humbur me shkatërrimin e objektit të banimit.
18. Gjykata Supreme konstaton edhe pse nuk është përmendur në ankesë Kërkesa e palës ankuese e as në Vendimin e KKPK-së, kërkesa ka qenë e papranueshme edhe për arsyet e cekura në nenin 18 të Ligjit nr. 03/L-079, i cili thotë: *“Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për çdo kërkesë nga neni 3.1 i kësaj Rregulloreje që është parashtruar pranë gjykatës me kompetencë territoriale, me kusht që procedura gjyqësore lidhur me kërkesën e tillë të mos ketë filluar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje”*. Rrjedhimisht, dispozita e nenit të cituar duhet të kuptohet se juridiksioni i AKP-së përjashtohet nëse pala ka dorëzuar kërkesë në gjykatën kompetente para datës 16 tetor 2010 (data e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Siç e ka bërë të qartë Komisioni në vendimin e vet *“provat e dorëzuara nga paraqitësja e kërkesës dhe të verifikuara nga Sekretaria Ekzekutive tregojnë se paraqitësja e kërkesës ka paraqitur padi në vitin 1997 dhe në vitin 2001 në Gjykatën Komunale të Pejës*.
19. Kërkesa ishte hedhur nga KKPK-ja për papranueshmeri për faktin se humbja e posedimit nuk lidhej me konfliktin dh kjo gjë është dëshmuar në shkresat e lëndës. Ecurinë e procedurave administrative të eksproprijimit dhe të procedurave para gjykatave të rregullta e ka pohuar edhe pala ankuese përmes shkresave të bashkangjitura kërkesës.

20. Edhe arsyetimi i KKPK-së në paragrafin 53 të vendimit në lidhje me kompozim ku hedhet kërkesa për kompensimin e dëmit sepse kjo bie jashtë juridiksionit të KKPK-së është i drejtë dhe në përputhje me ligjin.
21. Nga faktet e lartpërmendura rezulton se gjendja faktike në lidhje me këtë çështje ligjore është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se Vendimi i KKPK-së nuk është kundërshtuar me asnjë provë të vlefshme dhe si i tillë është ligjërish i qëndrueshëm dhe mirë i arsyetuar duke mos gjetur asnjë shkelje të ligjit [procedural apo të drejtës materiale.
22. Nga ajo që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Ragip Namani, gjyqtar,

Timo Eljas Torkko, referente e EULEX-it